



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.36, datë 26.06.2007

**“PER DHËNIEN NË ADMINISTRIM TË OBJEKTIT TË ISH NDËRMARRJES
RIPARIM MATERIALE POLIGRAFIKE, MINISTRISË SË DREJTËSISË”**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ", V.K.M. Nr.378, datë 12.08.1999 "Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", Ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil”, neni 305, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.351, datë 13.05.1996 “Për kalimin në përdorim të Ministrisë së Drejtësisë, të disa mjediseve të Shtypshkronjës “Mihal Duri”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Kalimin në administrim të Ministrisë së Drejtësisë, ish Ndërmarrjen Riparim Materiale Poligrafike (ndërmarrja Metalike “Tirana”), me adresë “Rruga e Kavajës” të objektit me të dhënat si më poshtë:
 - Sipërfaqja e objektit 336.09 m²
2. Bashkisë së Tiranës i mbetet e drejta e përfaqësuesit shtet mbi këtë pronë, e drejtë kjo që i ka kaluar në bazë të V.K.M. Nr.378 datë 12.08.1999. Ministria e Drejtësisë nuk ka të drejtën e tjetërsimit të kësaj prone.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R